



Republika Kosova
Republika e Kosovës
Opština Klokot-Vrbovac/Komuna e Kllokot-Vrbovcë

Datum : 31.05.2018 god.

Në bazë të nenit 12. Parasgrafi 12.2.(d) neni : neni 17. Paragrafi (h) , neni 45. Pika 45.1; neni 46 Paragrafi (1 i 2 ,) ; neni 47.pika : 47.1 ; neni 48.neni .52;paragrafi 52.1 i 52.2. Ligjit për Qeverisje Lokale nr . 03/L-040 , neni 2. Paragrafi 1.14.;1.25. ; 1.35. ; neni 5.paragrafi 1.5. ; 1.7. neni 7. Neni 10. Ligjit për arsimin parauniversitar , neni . 1 Paragrafi 1. Neni . 4. Paragrafi 1. Neni . 5. Ligjit për Arsim në komuna nr. 03/L-068 neni 1. Neni 7. Paragrafi 7.1. neni 18. Paragrafi (a) neni 28. Si dhe statuti komunal i Kllokot-Vërbovcit neni : 22. Pika 22.1. neni : 23. ; neni 26 paragrafi 26.1 i 26.2. Kuvendi Komunal merr :

Vendim për të konfirmuar funksionalizimin e shkollës "Marko Rajkovic " në Mogill nga parashkollor deri në klasën e katërt , e cila është paralele e ndarë nga shkolla amë me seli në Vërbovc .

Neni 1.

Kuvendi Komunal Kllokot-Vërbovc në seancën e pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të mbajtur më 31.05.2018. në "Shtëpinë e Kulturës " në Klokot, vendoset të konfirmohet funksionimi i shkollës "Marko Rajkoviç" në Mogill nga klasa parashkollore deri në klasën e katërt, e cila është paralele e ndarë e shkollës fillore me seli në Vrbovc.

Neni 2.

Për respektimin e ligjit në fuqi të cekur më sipër, Kuvendi Komunal me votim publik me 9 vota PËR , 1 kundër dhe 5 nuk janë deklaruar në votim në pajtim me nenin 1 të këtij vendimi, ka vërtetuar se egziston një sektor parashkollor si dhe klasat e klasës së parë deri në klasën e katërt në fshatin Mogillë me një program mësimor në gjuhën serbe. Nuk ka staf mësimor ekzistues për arsimin parashkollor në sistemin e Kosovës, si dhe për nxënësit e klasës së parë deri në klasën e katërt, si dhe personelin ndihmues të parashikuar me ligj . Komuna nën juridiksionin e saj në pajtim me ligjin për arsim në komuna në nenin 4. Nga paragrafi 1 dhe neni 5, në parim dhe paragrafi (c), kërkon nga autoritetet kompetente të punësojnë punëtorët. Ekzistojnë burime financiare në një grand të veçantë për pagesën e stafit të tillë. Vetëm duhet të aprovohet punësimi i punëtorëve i paraparë me ligj për institucionin arsimor, si dhe të zbatohet procedura ligjore gjatë punësimit të një numri të punëtorëve të miratohet pëlqimi për numrin e punëtorëve për shkollën në Mogila.

Neni 3.

Kuvendi komunal merr vendimin e përmendur në nenin 1 për qëllimet e nenit 2 për zbatimin e procedurës ligjore të përmendur në legjislacionin e lartpërmendur në fuqi, me qëllim që të sigurojë një arsimim të duhur parashkollor si dhe edukimin e nxënësve të klasave 1 deri në 4 në Mogillë.

Neni 4.

Pas miratimit të vendimit të Kuvendit Komunal për implementimin e tij, do të përkujdeset kryetari i komunës dhe drejtorija kompetente komunal për arsim, shëndetësi, shërbime sociale, kulturë, rini dhe sport.

Neni 5.

Ky vendim nga nenin 1 hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga kryetari i kuvendit të komunës së Kllokotit dhe vlerësimi i ligjshmërisë së Ministrisë kompetente për vetëqeverisje lokale dhe Ministrisë së arsimit të shkencës dhe teknologjisë të Ministrisë së Administratës Publike dhe është në fuqi deri në ndonjë plotësim apo ndryshim tjetër nga ana e Kuvendit

Kopja i dorzohet :

- MAPL;
- Kryetari Komunës ;
- Drejtorija e Administratës
- Drejtorija për arsim , shëndetësi, shërbime sociale, kultur , rini dhe sport
- Kryesuesi iKuvendit Komunal
- Arhiva Komunale

Kryesuesi iKuvendit Komunal
Kllokot-Vërbovc

Zarko Dejanovic